RREGULLORE

"PËR

PRAKTIKËN PROFESIONALE PËR PROFESIONISTIN E SHËNDETIT NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË"

Kjo rregullore nxirret në zbatim të nenin 11, të Ligjit Nr. 10171, datë 22.10.2009 "Për Profesionet e Rregulluara në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

KREU I PARË

TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Përkufizime

Në kuptimin e kësaj rregulloreje, termat e mëposhtme kanë këto kuptime:

a) Praktikë profesionale – është ushtrimi i profesionit nga ana e praktikantit për një periudhë të caktuar kohe nën udhëheqjen dhe përgjegjësinë e një profesionisti të kualifikuar dhe me përvojë, me qëllim për të fituar titullin profesional dhe për t'u aftësuar që ta ushtrojë atë si i pavarur.
b) Praktikant/Kandidat – individi i cili gëzon një dokument zyrtar të formimit universitar që kandidon për të ushtruar praktikën profesionale dhe fituar titullin e një profesioni të rregulluar.
c) Profesionist i kualifikuar me përvojë – është profesionisti i cili disponon një dokument zyrtar kualifikimi profesional dhe ka ushtruar profesionin në mënyrë të ligjshme dhe të pavarur për një periudhë mbi 3 (tre) vjet.

d) Urdhër Profesional (në vijim UP) - është autoriteti rregullator profesional në cilësinë e Entit Publik të pavarur, i cili përfaqëson interesat e përbashkëta të profesionistëve në një fushë të caktuar dhe rregullon marrëdhëniet midis tyre në funksion të publikut.
e) Dokument zyrtar i formimit/kualifikimit universitar – është diploma apo çertifikata që vërteton diplomimin për sa më sipër, në një program studimi universitar, të paktën 3 vjeçar për infermierin dhe fizioterapistin, të paktën 5 vjeçar me cikël unik për profesionin e farmacistit dhe stomatologut dhe 6 vjeçar me cikël unik për atë të mjekut, të ofruar nga një institucion i arsimit të lartë i akredituar për programin përkatës në Republikën e Shqipërisë në momentin e lëshimit të diplomës, apo vërtetimi i njësimit të diplomës së përfituar jashtë shtetit lëshuar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës (MASH) shoqëruar me diplomën/çertifikatën përkatëse të diplomimit.
f) Institucion Shëndetësor - është spitali, poliklinika, qendra shëndetësore, klinika dentare, farmacia e rrjetit të hapur dhe spitalore ku praktikanti ushtron praktikën profesionale apo pjesë të saj në përputhje me programin dhe profilin sipas profesionit.
g) Vlerësimi për aftësimin praktik (VAP) – është procesi që realizohet nëpërmjet testimit me gojë, për të vlerësuar aftësitë profesionale që kandidati ka fituar gjatë zhvillimit të praktikës profesionale.
h) Komisioni i Vlerësimit të Aftësimit Praktik (KVAP) – është autoriteti që vlerëson dhe përcakton nëse kandidati e kalon testimin e aftësimit praktik.

Neni 2
Parime të përgjithshme

1. Bazuar në Ligjin Nr. 10171, datë 22.10.2009 "Për Profesionet e Rregulluara në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, kandidati që zotëron një dokument zyrtar, për të fituar titullin profesional dhe të drejtën për të ushtruar profesionin si i pavarur, është i detyruar t'i nënshtrohet praktikës profesionale dhe vlerësimit të aftësimit praktik.
2. Çdo kandidat është i detyruar të paraqitet në zyrën qendrore të UP për t'u regjistruar dhe pajisur me dokumentacionin e nevojshëm për fillimin e praktikës profesionale.
3. Rregullat dhe kriteret e regjistrimit, pajisjes, si dhe tarifat për kryerjen e këtyre proçedurave përcaktohen dhe kryhen nga UP.
4. Çdo praktikant në përfundim të praktikës profesionale dhe marrjes së dëshmisë nga UP, i nënshtrohet provimit të shtetit.

KREU I DYTË

ORGANIZIMI I PRAKTIKËS PROFESIONALE

Neni 3
Zhvillimi i praktikës profesionale

1. Praktika profesionale synon përvetësimin efektiv të njohurive praktike - teknike dhe etike të profesionistit, i garanton atij aftësitë e domosdoshme dhe përgjegjësinë publike për ushtrimin e pavarur të profesionit.
2. Praktika profesionale kryhet në institucionin shëndetësor që plotëson standardet e domosdoshme për realizimin e kërkesave dhe përvetësimin e njohurive praktike - teknike dhe etike të praktikantit.

3. Praktika profesionale zhvillohet nën drejtimin dhe përgjegjësine e një profesionisti të kualifikuar që ka ushtruar profesionin në mënyrë të ligjshme dhe të pavarur për një periudhë mbi 3 (tre) vjet.
4. Ministria e Shëndetësisë përcakton dhe miraton listën e institucioneve të akredituara që kanë të drejtë të pranojnë praktikantë. Kjo listë është e shpallur pranë UP.
5. UP harton, miraton dhe shpall listën e profesionistëve, të cilët kanë të drejtë të udhëheqin dhe mbikëqyrin praktikantë, gjatë kryerjes së praktikës profesionale.
6. Praktikanti ka të drejtë të zgjedhë nga lista e shpallur institucionin dhe profesionistin udhëheqës të praktikës.
7. Ministria e Shëndetësisë dhe UP, kërkojnë nga institucionet shëndetësore dhe profesionistët që udhëheqin praktikantë zbatimin e detyrimit ligjor për të krijuar kushtet dhe për të marrë përgjegjësitë për zhvillimin normal të praktikës në përputhje me programin.
8. Periudha kohore e praktikës profesionale është, jo më pak se 3 (tre) muaj për praktikantin mjek dhe stomatolog, jo më pak se 6 (gjashtë) muaj (përfshi dhe praktikën e programit të formimit, të kryer në përfundim të studimeve të vitit të fundit) për praktikantin farmacist dhe jo më pak se 3 (tre) muaj për praktikantin infermier dhe profesionistë të tjerë të këtij rangu.
9. UP në bashkëpunim me stafin akademik të universiteteve publike dhe private të akredituara për programin përkatës të studimit, harton dhe miraton programin e praktikës.
10. UP harton kontratën tip të praktikës profesionale, në të cilën pasqyrohen të drejtat dhe detyrimet e palëve dhe që nënshkruhet midis udhëheqësit të praktikës dhe praktikantit.
11. Përjashtohet plotësisht apo pjesërisht nga detyrimi për kryerjen e praktikës profesionale, kandidati i cili provon se për një periudhë të caktuar në përputhje me kriteret specifike të profesionit që i përket, ka ushtruar profesionin përkatës apo ka kryer praktikën profesionale jashtë vendit, që i ka dhënë mundësi të përvetësojë një përvojë profesionale të mjaftueshme në fushën e këtij profesioni. Për të vlerësuar dhe për tu bindur nëse përvoja e kandidatit është e mjaftueshme për ta përjashtuar nga detyrimi për kryerjen e praktikës profesionale, UP mbështetet në një dokument zyrtar të lëshuar nga institucioni ku ka ushtruar veprimtarinë profesionale apo në një dokument zyrtar lëshuar nga nga UP/autoriteti kompetent i vendit përkatës për rastet kur është kryer një periudhë praktike profesionale jashtë vendit.

Neni 4
Regjistrimi i praktikantit në Urdhrin Profesional

1. Praktikanti, për të kryer praktikën profesionale, është i detyruar të regjistrohet në UP në një regjistër të vecantë.
2. Regjistrimi dhe pajisja e praktikantit me dokumentet e nevojshme për kryerjen e praktikës profesionale bëhet pranë zyrës qëndrore të UP. Për këtë qëllim praktikanti duhet të paraqitet me dokumentat e mëposhtme:

) Kërkesë me shkrim ku të jetë shprehur se njeh Kodin e Etikës dhe Deontologjisë, Betimin dhe Statutin e Urdhrit dhe se do t'i respektojë e t'i zbatojë ato me përpikmëri;
) Vetëdeklarim sipas formatit të përcaktuar nga UP;
) Pashaportë ose Kartë Identiteti;
) Dokument zyrtar që vërteton studimet sipas specifikimeve në pikën "e", të nenit 1.

e) Për ata që kanë kryer studimet jashtë shtetit, dokumenti zyrtar i njësimit nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës;
f) 3 (tre) copë fotografi 3x4 cm;
g) Tarifën e regjistrimit;
h) Dokumentat e mësipërme paraqiten të njësuara me origjinalin dhe mbeten pjesë e dosjes së aplikantit, që ruhet pranë UP përkatës.

Neni 5
Dokumentet me të cilat pajiset kandidati

Kandidati pasi regjistrohet, pajiset me dokumentat e meposhtëme:

a) Leje Individuale e Praktikantit (Çertifikatë e Praktikantit) – e cila i jepet praktikantit që plotëson kriteret e kryerjes së praktikës për periudhën e përcaktuar në nenin 3, të kësaj rregullore;
b) Kartë e praktikantit – është dokument identifikimi profesional;
c) Program i praktikës professionale;
d) Librezë e praktikës;
e) Formular i Vlerësimit të Praktikantit dhe bashkëlidhur tij, faksimile e vërtetimit të kryerjes së praktikës, që do të firmoset nga drejtuesi i praktikës.

Dokumentat e mësipërme janë të vlefshme vetëm për përiudhën e praktikës profesionale.

Neni 6
Të drejtat e praktikantit

Gjatë ushtrimit të praktikës profesionale, praktikanti:

1. Kërkon respektimin e kontratës së nënshkruar për praktikën profesionale.
2. Merr pjesë dhe aktivizohet në të gjitha aktivitetet me interes shkencor profesional teorik dhe praktik që zhvillohen.
3. Ndjek dhe aktivizohet në format dhe programet e Edukimit të Vazhdueshëm Profesional me interes për aftësimin e tij profesional.
4. Ankohet tek drejtuesi i institucionit, si dhe në strukturat më të afërta të UP për veprime që bien ndesh me këto të drejta apo tjetër veprim që e pengon, i krijon vështirësi, apo pamundësi në zhvillimin efektiv të praktikës profesionale.
5. Praktikanti që për arsye të justifikuara shkëput kontratën ekzistuese, për periudhën e mbetur, nënshkruan kontratë me një drejtues tjetër praktike.

Neni 7
Përgjegjësitë e praktikantit

Praktikanti duhet:

a. Të marrë pjesë rregullisht në praktikë dhe të zbatojë programin e saj.
b. Të krijojë dhe të mbajë marrëdhënie korrekte të bazuara në mirësjellje dhe respekt të ndërsjelltë me profesionistin që udhëheq praktikën, kolegët dhe personelin tjetër si dhe drejtuesin e institucionit.
c. Të njohë Kodin e Etikës e Deontologjisë, veprimtarinë dhe sjelljen e tij profesionale ta bazojë në parimet dhe dispozitat e këtij Kodi.
d. Të trajtojë me maturi, humanizëm, kompetencë dhe përgjegjësi të lartë profesionale të sëmurin dhe publikun me të cilët komunikon.
e. Të bëjë përpjekje për përvetësimin maksimal të njohurive praktike - teknike që i shërbejnë ngritjes dhe aftësimit të tij profesional. Të ndjekë dhe të marrë pjesë në aktivitete shkencore, konsulta etj.
f. Të zbatojë e respektojë me përpikmëri rregullat dhe statutin e institucionit ku kryen praktikën.
g. Të nënshkruajë me fillimin e praktikës profesionale, kontratën tip të praktikantit, një kopje të së cilës ta depozitojë pranë zyrës qendrore të UP.

Neni 8
Të drejtat e profesionistit që udhëheq praktikantin

Profesionisti që udhëheq praktikantin ka të drejtë:

1. Të anullojë kontratën në rast të shkeljes së detyrimeve të saj nga ana e praktikantit dhe të njoftojë strukturat më të afërta të UP.
2. Për udhëheqjen e një praktikanti gjatë një cikli të plotë praktike të përfitojë 10 (dhjetë) kredite të vlefshme për përmbushjen e programit të edukimit në vazhdim.
3. Për vështirësitë dhe pengesat që i krijohen në zbatimin e programit të miratuar, të njoftojë UP dhe strukturat drejtuese nga të cilat varet
4. Udhëheqësi i praktikës nuk mund të ndjekë në të njëjtën kohë më shumë se një praktikant.

Neni 9
Përgjegjësitë e profesionistit që udhëheq praktikantin

Profesionisti që udhëheq praktikantin duhet:

1. Të njohë programin e praktikës profesionale dhe të kërkojë zbatimin e tij nga ana e praktikantit.
2. Të njohë parimet Kodit të Etikës dhe Deontologjisë, si dhe të kërkojë zbatimin dhe respektimin e tyre në zhvillimin e praktikës.
3. Të sigurojë dhe të përgjigjet për mbarëvajtjen e praktikës profesionale.
4. Të mbikëqyrë frekuentimin e rregullt të praktikantit dhe ta dokumentoje atë në Librezën e Praktikës.
5. Të jetë kontribues dhe miqësor në edukimin dhe formimin profesional të praktikantit.
6. Të kujdeset në respektimin dhe zbatimin e kontratës së nënshkruar me praktikantin.
7. Të plotësojë me saktësi e përgjegjësi Formularin e Vlerësimit të Praktikantit.

Neni 10
Të drejtat dhe përgjegjësitë e UP

UP përveç të drejtave dhe përgjegjësive të përcaktuara në nenet përkatëse të kësaj rregullore ka të drejtë:

1. Të mbikqyrë dhe sigurojë zhvillimin normal të praktikës profesionale nëpermjet strukturave të tij
2. Të dokumentojë dhe vlerësojë informacionet ankimore me shkrim të dërguara nga udhëheqësi i praktikantit, praktikanti, drejtuesi i institucionit, strukturat e UP, pacienti, publiku, media dhe sipas rastit, i bën objekt të gjykimit disiplinor profesional.

Neni 11
Përfundimi i praktikës profesionale

1. Praktikanti në përfundim të praktikës profesionale, dorëzon të plotësuar pranë zyres qëndrore të UP Formularin e Vlerësimit të Praktikantit si dhe vërtetimin bashkëlidhur.
2. Pas verifikimit dhe vlerësimit të Formularit dhe dokumentacionit të dosjes së praktikës UP vendos për regjistrimin e kandidatit në Vlerësimin e Aftësimit Praktik.

KREU I TRETË

VLERËSIMI I AFTËSIMIT PRAKTIK

Neni 12
Institucionet përgjegjëse

Vlerësimi i aftësimit praktik organizohet dhe zhvillohet nga Ministria e Shëndetësisë në bashkëpunim me UP.

Neni 13
Regjistrimi dhe pranimi në VAP

1. Pranimi i kandidatëve në vlerësimin e aftësimit praktik bëhet nga UP.
2. Kërkesa për regjistrim bëhet me shkrim jo më vonë se 15 ditë para zhvillimit të vlerësimit të aftësimit praktik.
3. Lista e kandidatëve të regjistruar e përgatitur nga UP i dorëzohet Komisionit të Vlerësimit të Aftësimit Praktik ditën e zhvillimit të testimit.

Neni 14
Koha e zhvillimit të VAP

Vlerësimi i aftësimit praktik organizohet 2 (dy) herë në vit në këto periudha kohore:

a) Gjatë muajit tetor
b) Gjatë muajit prill.

Neni 15
Pyetjet orientuese të VAP

1. Pyetjet orientuese përgatiten nga një grup pune i ngritur me urdhër të Ministrit të Shëndetësisë, i përbërë prej të paktën tre profesionistësh të caktuar: një nga MSH dhe dy nga UP përkatës.
2. UP administron kandidaturat dhe organizon punën për përgatitjen në kohë të pyetjeve orientuese.
3. UP shpall pyetjet orientuese 1 (një) muaj përpara zhvillimit të vlerësimit të aftësimit praktik.
4. Shpërblimi i anëtarëve të grupit të punës bëhet nga UP sipas akteve nënligjore në fuqi.

Neni 16
Rregullat e kryerjes së VAP

Kandidatët që do ti nënshtrohen vlerësimit të aftësimit praktik duhet të zbatojnë rregullat e mëposhtme:

1. Të jenë të pajisur me kartë identiteti ose pasaportë.
2. Të paraqiten 30 minuta para fillimit të vlerësimit.
3. Të jenë të pajisur me mjetet e nevojshme për zhvillimin e testimit.
4. Ndalohet marrja me vete dhe përdorimi i celularëve dhe mjeteve të tjera të komunikimit gjatë zhvillimit të vlerësimit, pasi kjo konsiderohet si kriter skualifikimi.
5. Ndalohet duhani, alkooli dhe konsumimi i ushqimit në mjediset ku zhvillohet testimi.
6. Ndalohet komunikimi gjatë zhvillimit të vlerësimit të aftësimit praktik.
7. KVAP është përgjegjëse për mbarëvajtjen dhe zhvillimin e procesit.

Neni 17
Komisioni i Vlerësimit të Aftësimit Praktik

1. Komisioni i Vlerësimit të Aftësimit Praktik (KVAP) përbëhet nga 3 (tre) profesionistë, me eksperiencë së paku 7 (shtatë) vjeçare në ushtrimin e profesionit, të caktuar me Urdhër të Ministrit të Shëndetësisë, si më poshtë :

   a. Një përfaqësues i caktuar nga Ministri i Shëndetësisë.
   b. Dy përfaqësues të caktuar nga UP përkatës.

2. Kryetari i KVAP është përfaqësuesi i Ministrisë së Shëndetësisë.
3. Shpërblimi i anëtarëve të komisionit bëhet nga UP përkatës sipas akteve nënligjore në fuqi.

Neni 18
Zhvillimi i VAP

1. Vlerësimi i aftësimit praktik zhvillohet me gojë, në datat e përcaktuara.
2. Pranohen për vlerësim të aftësimit praktik kandidatët, në përputhje të plotë me listën e shpallur nga UP.
3. Tezat e vlerësimit të aftësimit praktik, janë kompetencë e KVAP-së dhe synojnë të vlerësojnë njohuritë e fituara gjatë kryerjes së praktikës profesionale.

4. KVAP, brenda ditës, shpall rezultatin e vlerësimit të kandidatëve pjesëmarrës dhe harton procesverbalin e rezultateve.
5. Procesverbali i vlerësimit të aftësimit praktik është i vlefshëm vetëm kur firmoset nga të gjithë anëtarët e Komisionit.

Neni 19
Vlerësimi i aftësimit praktik

1. Praktika Profesionale konsiderohet e kryer vetëm pas vlerësimit pozitiv të aftësimit praktik.
2. Vlerësimi i aftësimit praktik cilësohet pozitiv, nëse kandidati është vlerësuar me 50-100 pikë (kalueshëm). Kandidati i vlerësuar me 0-49 pikë (jokalueshëm) përsërit vlerësimin e aftësimit praktik.

Neni 20
Përsëritja e VAP

Kandidati ka të drejtë t'i nënshtrohet vlerësimin të aftësimit praktik, jo më shumë se 5 (pesë) herë. Kur vlerësimi i aftësimit praktik është pozitiv, nuk lejohet të përsëritet.

Neni 21
Tërheqja nga vlerësimi i aftësimit praktik

1. Nëse një kandidat nuk paraqitet në vlerësimin e aftësimit praktik në datën, orën e caktuar ose tërhiqet përpara fillimit të tij, atëherë vlerësimi nuk konsiderohet si i kryer.
2. Tërheqja nga vlerësimi i aftësimit praktik nuk mund të kryhet pas hyrjes në sallën e testimit.

Neni 22
E drejta e ankimimit

1. Kandidati ka të drejtë të ankimojë me shkrim para Komisionit të VAP nëse ka kontestime për rezultatin e vlerësimit në momentin e testimit me gojë .
2. KVAP pas rishqyrtimit të ankesës së kandidatit brenda 2 (dy) ditëve, jep vlerësimin përfundimitar.

Neni 23
Dështmia e praktikës profesionale

1. Komisioni i VAP dorëzon procesverbalet e vlerësimit pranë UP brenda 3 (tre) ditëve.
2. UP pajis kandidatët fitues me Dëshminë e Kryerjes së Praktikës Profesionale.
3. UP mban të dhënat përfundimtare për të gjitha vlerësimet e aftësimit praktik, për një periudhë 5 (pesë) vjeçare

Neni 24
Tarifat për regjistrimin dhe vlerësim të praktikantit

1. Praktikanti është i detyruar të paguajë pranë UP tarifën e përcaktuar, për të gjitha procedurat e kryera për regjistrimin dhe dokumentet e lëshuara, procesin e mbikëqyrjes nga strukturat e UP, vlerësimin e aftësimit praktik dhe rivlerësimin e aftësimit praktik.
2. Masa e tarifës përllogaritet nga zyra qendrore e financës pranë UP dhe miratohet me Vendim të Këshillit Kombëtar të UP.

Neni 25
Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë.

Ministri i Shëndetësisë

Vangjel TAVO

Ministri i Arsimit dhe Shkencës

Myqerem TAFAJ